REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 135/17
Datë/Datum. 29.05.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	**Menaxherin e prokurimit:** Spitali i Përgjithshëm Pejë	Kopje:	Paneli Shqyrtues - **OSHP Nr.135/17**
Nga:	Safije Saramati- Eksperte Shqyrtuese Muhamet Kurtishaj - Ekspert teknik		
Lënda:	**"Furnizim me gjenerator ligashure (thik / koagulator) ultrasonik dhe bipolar i avansuar"** me nr. prokurimi 70030 17 008 121		
Përgjigjeje në ankesë:	**OE "Solution D"** me seli ne Prishtinë		
Datë	29.05.2017		

Bazuar në nenin 113 dhe 114 të LPP-së ju njoftojmë me raportin e lëndës lidhur me aktivitetin e **"Furnizim me gjenerator ligashure(thik/koagulator) ultrasonik dhe bipolar i avansuar"** me nr. prokurimi 70030 17 008 121 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Spitali i Përgjithshëm Pejë** dhe me përgjigjeje ndaj ankesës së operatorit ekonomik **"Solution D"** me nr.**135/17** të datës **11.05.2017**.

Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa IX e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i pavarur, ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit, përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues
1X1 Operatorit ekonomik ankues

		18.05.2017		19.05.2017		29.05.2017
Nënshkrimi i ekspertit		Data e pranimit të autorizimit		data e fillimit të ekspertizës		data e dorëzimit të raportit

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit-

Me datë **11.05.2017** Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesat me numër të protokollit **Nr.135/17** e parashtruar nga operatori ekonomik **"Solution D"** me seli ne Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me gjenerator ligashure(thik/koagulator) ultrasonik dhe bipolar i avansuar"** me nr. prokurimi 70030 17 008 121 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Spitali i Përgjithshëm Pejë.**

Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa IX e LPP-së, Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si më poshtë:

N. 111,- ***OE Ankues*** **konzorciumi "Solution D"** me seli ne Prishtinë

Pikat e Ankesës:

Është shkel neni 1 i LPP (Qëllimi)
Është shkel neni 6 i LPP (Ekonomiciteti dhe efikasiteti)
Është shkel neni 7 i LPP (Barazia ne trajtim/ jo diskriminimi)
Është shkel neni 52 i LPP (Njoftim i kritereve për dhënien e kontratës)
Është shkel neni 59 i LPP (Ekzaminimi , vlerësimi dhe krahasimi i tendereve)

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Me dt:24.04.2017 jemi njoftuar me letren standarde per tendentes te pasuksesshem.
Me dt:28.04.2017 kemi bere kerkesen per rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.
Me dt:03.05.2017 kemi man pergjigje per refuzim te kerkeses tone per rishqyrtim.

Ne lidhje me kete tender ne kemi pasur qasje pjeserisht ku Autoriteti kontraktues na dorezoi 46 flete te dosjes se tenderit por me kerkese ne qasje tek raporti i vleresimit te tenderit NUK na u prezantua apo dorezua Raporti i vieresimit nga komisioni per vleresim te ofertave. (shih fakt nr. 2 Memo e jashtme Kerkese per gasje ne dokumentet e dosjes se tenderitl. Keshtu (tie nuk eshte respektuar ne teresi edhe neni 10 i LPP.
Në kete aktivitet te prokurimit autoriteti kontraktues e ka shpallur fitues operatorin "Konti" i cili nuk i ploteson specifikimet teknike te detyrueshme.
0.E i shpallur fitues nuk ka ofertuar me produktet e kerkuara ne pajtim me specifikacionet teknike. Ne oferten e 0.E `KONTI' nuk jane gjendur produktet e kerkuara me specifikacionin teknik.
Mos-ofertimi i produkteve te kerkuara ne pajtim me specifikacionet teknike konsiderohet e rende e neinit 59 te LPP-se dhe oferta e OE „KONTI" duhet te shpallet e pa pergjegjeshme.
Ne dosje te tenderit tek specifikacionet teknike dhe ne bazë të aneksit 1 është kërkuar si në vijim: Gjenerator elektrokirurgjikal me mundesi te prodhimit tE energjise **ultrasonike** dhe energjise se avancuar bipolare ndersa 0.E i shpallur fitues nuk ka ofertuar me gjenerator ektrokirurgjikal me mundesi prodhimi te energjise ultrasonike por vetem energji monopolare dhe bipolare. Keshtu qe pajisja e ofruar nga prodhuesi BOWA, pajisja ARC 350 nuk permbush kriteret themelore te kerkuara me specifikimet telcmike te detyrueshme. Shih fakt nr.3- katlogu i pajisjes ARC 350 i printuar. Gjate analizimit te ofertes se bashkangjitur nga C C {nr.094 me referencat e procilmesit} shpallur flues eshte verejtur se instrumentet e ofruara per pjesen e Specifikimeve teknike te detyrueshme / Materiali

shpenzues nga operatori i rekomanduar per kontrate nga numri rendor 1 deli 5 nuk_ janë paitueshrneri me specifikacionet teknike te kerkuara. Tek produktet shihet (de kryesisht jane produkte liguese / ngjitese gjersa specifikacionet teknike te kerkuar jane instrumente uRtrasonike. (Per detaje shih te bashkangjitur katalogun e produkteve te ofertuar}

4.1. Instrumenti ultrasonike të kerkuara -tek materiali shpenzues:
Thike per laparaskopi me diameter 5 mm dhe gjatesi te instrumentit 23 cm. Nigh KNIFE, 200 mm (REF770-200} thika dhe
Thike per kirurgji te hapur me diameter 5 mm dhe gjatesi te instrumentit 36 cm. NightKNIFE set, 36 mm Comfort (REF770-300}
Jane dhene me referenca te njejte sikurse paisjet percjellese te paisjes nen 5 dhe 6
- (Hand piece - Mbajtese me kabell per shendrimin e nymes elektrike ne energji ultrasonike dhe
- Hand piece - Mbajtese me kabell per shenderrimin e rrymes elektrike ne energji ultrasonike\

Me poshte jane sqraimet se si nuk i ka permbushur specinkimet teknike te detyrueshme operatori ekonomk iyekomanduar per kontrate.
Tek materiali shpenzues eshte kerkuar:

1. Instrument Ultrasonik — Thike per laparaskopi me diameter 5 mm dhe gjatesi te instrumentit 23 cm.

Eshte ofertuar instrumenti (ref: 770-200 si instrument ultrasonik me diameter 10 mm me gjatesi 20 cm.

2. Instrument Ultrasonik — Thike per kirurgji te hapur me diameter 5 mm dhe gjatesi te instrumentit 36 cm.

Është ofertuar instrumenti (ref: 770-300 si instrument ultrasonik me diameter 10 mm dhe me gjatesi 36 cm.

3. Instrument Ultrasonik — Thike per kinirgi te hapur me diameter 5 mm dhe gjatesi te instrumentit 14 cm.

Është ofertuar instrumenti (ref: 771-011 dhe 770-221 si instrument ultrasonik me diameter 10 mm dhe me gjatesi 11 cm.

4. Instrument Ultrasonik — Thike per kirurgji te hapur me madhesi te instrumentit 17 cm.

Eshte ofertuar instrumenti (ref: 770-236 si instrument ultrasonik me gjatesi 36 cm.

5. Instrument Ultrasonik — Thike per kirurgji te hapur me diameter 9 cm.

Është ofertuar instrumenti (ref: 772-011 dhe 770-221 si instrument ultrasonik me gjatesi 11 cm.

6. Instrumenti për energji të avancuar bipolar për kirurgji të hapur dhe laparaskopi me diametër 5 mm dhe gjatësi të instrumentit 35 cm.

Eshte ofertuar instrumenti (ref: 771-036 si instrument bipolar me gjatesi 36 cm

Vërejtjeët tona në gjatësi/madhësi konsistojnë se produktet në madhësi të ofruara janë instrumente laparaskopike dhe janë ofertuar për përdorim në kirurgji të hapur.
Per te gjitha pretendimet e mesiperme shlh faktin nr. 4 - ;Lista e artikujve te 0.E te shpallur Miles qe nuk eshte nC pajtim me specifikacionet teknike ne haze te Katallogjeve te ofruara). Keto fakte qe i cekem me larte shume lehte vertetohen nese shikohet oferta e operatorit ekonomik te rekomanduar per kontrate-Konti-. Pra operatori ekonomik i rekomanduar per kontrate nuk i ka plotesuar kerkesat mbi mundesite teknike dhe-ose profesionale te parashikuara ne nenin 9.1 te FDT.

Ne gjate qasj es ne dokumente i kemi vertetuar dhe sqaruar keto fakte qe e bejne te papergjegjshem kete operator ekonomik.
Autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar nenin 52 te LPP pasi qe ane dosje te tenderit e ka parashikuar qe kriter per dhenie te kontrates eshte tenderi i pergjegjshem me cmim me le ulet ndersa me rastin e rekomandimit per kontrate nuk e ka respektuar kete kriter, duke e rekomanduar per kontrate operatorin qe ka ofruar cmim me te lire por qe eshte i papergjegjshem.

Autoriteti kontraktues duke e shpallur fitues operatorin ekonomik i cili nuk i ploteson kerkesat dhe specifikimet teknike te detyrueshme e ka shkelur nenin 59 te LPP-se e posacerisht paragrafin 4 te ketij neni ku shkruan citojme;

Autoriteti kontraktues do te konsideroje nje tender site pergjegjshem vetem nese tenderi ne fjale eshte ne perputhshmeri me te gjitha kerkesat e parashtruara ne njoftimin e kontrates dhe ne dosjen e tenderit, mbarim citati.
Pra ky nen eshte shkelur ne menyre substanciale pasi qe operatori ekonomik i rekomanduar per kontrate nuk i ka plotesuar elementet kryesore te pajisjes ashtu sic eshte cekur me larte. Mirepo ne kete rast edhe nese nuk do ta plotesonte vec nje element apo kerkese te specifikimeve teknike atehere ky operator ekonomik konsiderohet i papergjegjshem duke ju referuar paragrafit 4 te nenit 59 te LPP, pasi qe ne kete nen po shkruan qarte, qe se nje tender mund te konsiderohet i pergjegjshem vetem nese tenderi ne fjale eshte ne perputhshmeri me te gjitha kerkesat e dosjes se tenderit. Kurse operatori ekonomik i rekomanduar per kontrate nuk i ka plotesuar nje numer te madh te kerkesave te AK dhe te specifikimeve teknike te detyrueshme. Poashtu ne dosje te tenderit nuk jane autorizuar variantet. Pra operator& ekonomik e kane pasur te ndaluar qe te ofertojne me variantedimensione tjera dhe te ndryshme.

Gjate ekzaminimit, vleresimit dhe krahasimit te ofertave autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar nenin 7 te LPP-se pasi qe neve si operator ekonomik që i plotesojme te gjitha kerkesat e dosjes se tenderit dhe qe kemi ofruar crnim me te lire auk na ka shpallur fitues, pra na ka diskriminuar dhe nuk na ka trajtuar ne menyre te barabarte ashtu sic eshte e obliguar ta beje nje gje te title sipas nenit 7 te LPP-se, mirepo AK e ka favorizuar operatorin ekonomik te papergjegjshem.
Me kete veprim autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar edhe nenin 1 te ILPP pasi qe aty shkruan qarte citojme .:Qeffirni ketij ligji eshte te siguroj menyren me efikase,, me transparente clhe me te drejte te shfryteziTit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te g,jittla fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktuese ne Kosove; mbarim citati.
Autoriteti kontraktues rue rastin c rekomandimit per kontrate operatorin ekonomik Le papergjegjshem nuk e ka respektuar edhe nenin 6 te LPP, pasi qe me kete veprim nuk ka mundur te deshmoje dhe te siguroje qe fondet clhe burimet publike jane perdore në menyre ekonomike.

Se operatori ekonomik i rekomanduar per kontrate nuk i ka ofruar disa dimensione ashtu sic eshte kerkuar e ka pranuar edhe vete AK, mirepo qe keto rnungesa i ka cilesuar se nuk jane pengese per nderhyrje .kirurgjike, por ne sqarojme dhe terheqim vemendjen se cdo nderhyrje kirurgjike eshte me peshe dhe rendesi te madhe dhe bart rreziqe potenciale prandaj per shkak te kesaj rendesie jane vendosur dhe kerkuar nga njesia kerkuese dimensionet dhe te gjitha kerkesat ashtu si ne dosje te tenderit, kurse zyra e prokurimit ne kete rast po del te jete me profesionale ne kete fushe se sa njesia e kerkeses e cila eshte e obliguar me LPP te beje-hartoje speeifikimet teknike te detyrueshme. Prandaj na habit fakti se nje zyrtar apo menaxher i prokurimit merr guximin te minimizoje rolin dhe rendesine -e dimensioneve te percaktuara dhe te kerkuara nga njesia kerkuese dhe te rekomand.oje fitues OE i cili nuk ka ofertuar ashtu sic eshte kerkuar nga vete autoriteti kontraktues.

Dëmet Materiale

Demi material i shkaktuar konsiston ne shpenzirnet e shurnta materiale ne pergaditjen dhe dorezimin e Tenderit duke perfshire edhe shpenzimet tjera ligjore, e qe e arrijne vleren prej 500.00 €.

Propozim

Kompania 'SOLUTION D' kerkon nga Organi Shqyrtues 11,Prokurimit qe gjate shqyrtimit te fakteve ligjore te **aprovoje ankesen tone site bazuar dhe te ANULON**, Vendimin per dhenie te kontrates, per te kthyer lenden ne **Rivleresim** dhe qe te obligohet autoriteti kontraktues qe gjate rivleresimit te ofertave te behet korrigjimi i gabimeve dhe i leshimeve qe jane bere me rastin e ekzarninimit, vleresimit dhe krahasimit te ofertave.

Procesi i prokurimit

Data e njoftimit për kontratë(N.40) : 21.03.2017
Lloji i procedurës së aplikuar (N.32-35):-.....Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar(N.16): .....Furnizim/e mesme
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë): .....20.04.2017 ora 12ºº
Data e hapjes së ofertave (N.58) -.....20.04.2017 ora 12ºº
Data e njoftimit për dhënie te kontratës.....nuk eshte bërë.

III.2 KUSHTET PËR PJESMARRJE

III.2.2- Përshtatshmëria profesionale

Kerkesa

1. Regjistri i operator ekonomik në regjistrin profesional,komercial dhe /apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj te themelimit.
2. Çertifikata e numrit fiskal.
3. Autorizimi origjinal nga prodhuesi ose dilerit të autorizuar për shitje dhe servisim te paisjes me te cilen ofertoni.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Evidenca 1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti perkatës publik në vendin e themelimit te operatorit ekonomik me te cilen evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (kopja e regjistrimit te biznesit se bashku me informatorin e veprimtaris).

Evidenca 2. Kopja e Çertifikates te numrit fiskal.

Autorizimi per pjesëmarje në ketë tender (70030/17/008/121) nga prodhuesi –origjinali i nënshkruar dhe i vulosur nga prodhuesi ose dilerit të autorizuar (i cili duhet te permbaj te dhena te mjaftueshme per prodhuesin, veçanerisht detajet e kontaktit: adresa , nr.tel/fak.e-mail ,ëebsite)

III.2.3 Kapaciteti ekonomik dhe financiar N/A

III.2.4 Kapaciteti teknik dhe profesional

1. Katalogu nga prodhuesi ose dilerit te autorizuar, për produktin me te cilin ofertoni
2. Çertifikatat e kualitetit te produkteve duke u bazuar në specifikimet dhe standardet përkatëseISO-Standardet.
3. Çertifikata e CE- Konformitetit

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Katalogu nga prodhuesi ose dilerit te autorizuar për produktin me te cilin oferton, ku ofertuesi është i obliguar qe ne katalog te nënvizoj specifikimin teknik te pajisjes me te cilen oferton, mos nenvizimi i katalogut oferten e benë te pa pergjegjshme
2. Çertifikatat e kualitetit te produkteve duke u bazuar në specifikimet dhe standardet përkatëse- ISO-Standardet.
3. Çertifikata e CE- Konformitetit.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N.58):

Nr.	Emri i Tenderuesit	Vendi	Çmimi €	Vërejtje
1	NShT. "KONTI"	Prizren	24.464,16	jo
2	"Solution D"	Prishtinë	31.821,12	jo

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve konstatohet se ne hapjen e ofertave kanë marrë pjesë përfaqësuesit e OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi dhe çmimi. Nuk ka pasur vërejtje për procesin e hapjes se ofertave nga asnjë operator ekonomik. Raporti i hapjes është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes dhe përfaqësuesit e operatorëve ekonomik te pranishëm.

Kriteret për vlerësim

Kriteri për dhënien e kontratës (N.60):..... Tenderi i përgjegjshëm **Çmimi më i Ulët**

Komisioni vlerësimit pranë AK

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues (N.80).

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka formuar komisionin me vendimin e datës 21.04.2017 në përbërje prej tre anëtarëve:

1. Dr. Naim Logja - Kryetar i Komisionit
2. Dukagjin Peli - Anëtar
3. Bekim Ramaj- Anëtar

Data e mbarimit të vlerësimit të ofertave:.....21.04.2017

Data e e nënshkrimit nga zyrtari i prokurimit.....31.04.2017

Raporti i komisionit vlerësues

OE i rekomanduar për dhënie të kontratë:

NShT. **"KONTI"** me ofetën në vlerë prej **24.464,16 €uro.**

Komisioni vlerësues ka konstatuar dhe vlerësuar si në vijim:

Operatoret që kanë ofertuar janë 2(dy)

Operatoret ekonomik të përgjegjshëm janë 2

Operatoret ekonomik të pa përgjegjshëm janë 0

Deklarata e komisionit vlersues

Komisioni i vlerësimit pas kontrollit dhe verifikimit të ofertave rekomandon për dhënie të kontratës OE NShT **"KONTI"** me cmimin e ofertës në vlerë prej **24.464,16 €uro** për arsye se oferta është e përgjegjëshme i përgjigjet specifikimit teknik të kërkuar dhe ka cmimin më të ulët se oferta tjetër.

Rishqyrtimi i kërkesës nga Autoriteti Kontraktues

E datën 28.04.2017, autoriteti kontraktues ka pranuar kërkesën për rishqyrtim të parashtruar nga OE **"Solution D"** lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me gjenerator ligashure(thik/koagulator) ultrasonik dhe bipolar i avansuar"** me nr. prokurimi 70030 17 008 121. Me datën 03.05.2017 lidhur me kete kërkesë Autoriteti kontraktues mori këtë:

Vendim

Refuzohet si te pa bazuara kërkesa për rishqyrtim të paraqitur nga OE konzorciumi **"Solution D"** lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me gjenerator ligashure(thik/koagulator) ultrasonik dhe bipolar i avansuar"** me nr. prokurimi 70030 17 008 121.

Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues (N. 113,114)

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të Lëndës së Tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në dokumentacionin që ka pasur në dispozicion eksperti shqyrtues-teknik jep mendimin si në vijim:

Konstatimi: Nr. 1

Ky aktivitet i prokurimit është publikuar nga autoriteti kontraktues me procedurë të hapur. Lloji i kontratës është furnizim, kontratë publike me vlere te mesme.

Në dosjen e tenderit janë dhënë informata përkatëse lidhur me kontratën në fjalë. Dosja përfshinë të gjitha termet dhe kushtet materiale të sajë, procedurat e zbatueshme të prokurimit, kërkesa të aplikueshme të përshtatshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes. Kriteri i dhënies së kontratës është në harmoni me dispozitat e LPP-së.

Konstatimi nr. 2

Gjatë shqyrtimit të kësaj lënde, Eksperti shqyrtues/teknik në përputhje me nenin 113 pika 1 të LPP-së, jep mendimin për pretendimet ankimore të OE ankues si në vijim:

Pretendimi i OE ankues se paisja e ofruar nga OE i rekomanduar per kontratë nuk është në përputhje me specifikacionin teknik të dosjes së tenderit sepse pajisja në fjalë nuk prodhon energji Ultrasonice por prodhon vetëm energji monopolare dhe bipolare, eksperti teknik mendon se ky pretendim është i **bazuar**. OE fitues ka ofruar pajisjen ARC 350 te prodhuesit BOWA ku sipas katalogut të ofruar, eksperti teknik nuk ka mundur të vërtetoj se kjo pajisje ofron energji Ultrasonice.

Konstatimi nr. 3

Pretendimi tjetër i OE ankues ka të bëjë me specifikimet teknike të instrumenteve ultrasonice te materiali shpenzues që OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka ofruar sipas specifikimit teknike të dhënë në dosjen e tenderit. Po i veqojm disa prej tyre të cilat i ka theksuar edhe OE ankues si janë kërkuar në dosjen e tenderit dhe si janë ofruar nga OE fitues:

- Është kërkuar në DT- Instrumenti ultrasonic- thikë për laparaskopi me diametër 5 mm dhe gjatësi të instrumentit 23 cm

Ndërsa është ofruar nga OE fitues- Instrumenti ultrasonic me diametë 10 mm me gjatësi 20 cm. Pra është një diferencë prej 5 mm te diametrit më të madhe se qe eshte kerkuar dhe 3 cm gjatësi më të vogël se që eshte kerkuar.

- Është kërkuar në DT- Thikë për kirurgji të hapur me diametër 5 mm dhe gjatësi të instrumentit 36 cm.

Kurse është ofruar nge OE fitues- Instrumenti Ultrasonic me diametër 10 mm dhe gjatësi 36 cm. Pra diametri është edhe një herë më i madh se është kërkuar.

- Është kërkuar në DT- Thikë për kirurgji të hapur me diametër 5 mm dhe gjatësi të instrumentit 14 cm.

Kurse është ofruar nga OE fitues- Instrumenti Ultrasonic me diametër 10 mm me gjatësi 11 cm. Pra diametri i instrumentit është edhe një herë më i madhë se është kërkuar, ndërsa gjatësia 3 cm më e vogël se e kerkuara.

- Është kërkuar në DT- instrumenti Ultrasonic- thikë për kirurgji të hapur me madhësi të instrumentit 17 cm.

Ndërsa është ofruar nga OE fitues- instrumenti Ultrasonic me gjatësi 36 cm. Pra gjatësia e instrumentit është edhe një herë më e madhe se që është kërkuar.

Përveq këtyre pajisjeve që i theksuam me larte ka edhe paisje të tjera te ofruara nga OE i rekomanduar per kontrate që nuk janë në përputhje me specifikacionin teknik të dosjes së tenderit.

Prandaj eksperti shqyrtues-teknik, vlerëson se ky pretendim ankimor i OE ankues është **i bazuar** dhe si rrjedhim OE i rekomanduar për kontratë është i **pa përgjegjshëm** sepse nuk i ka ofruar pajisjet në përputhje me specifikimin teknik të dosjes së tenderit.

Konstatimi nr. 4

Nga këto qu përmendën më lartë konstatojmë se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar pajisjet të cilat nuk janë në përputhje me specifikimin teknik të dosjes së tenderit.
Në përgjigjëjen e kërkesës për Ri shqyrtim që autoriteti kontraktues i ka dhënë OE ankues, ka pranuar se pajisjet e ofruara prej OE të rekomanduar për kontratë nuk janë sipas specifikimit teknik por ka theksuar për disa nga ato, se nuk pengojnë në ndërhyrjet kirurgjike.

Eksperti teknik vlerson se munden të lejohen devijime të vogëla edhe teknike qofshinë ato, mirëpo nëse përmasat e pajisjes ndryshojnë për nga madhësia 100% me atë që është kërkuar ne dosjen e tenderit siç është rasti tani për disa nga ato që i përmendëm më lartë, atëherë kjo është e pa pranueshme në aspektin teknik.
Nëse këto dimensone të paisjeve nuk janë pengesë per ndërhyrje kirurgjike siç e ka theksuar autoriteti kontraktues për disa prej tyre, atëherë pse nuk është parapar në specifikacion teknik një tolerancë e tillë për pajisjet e kerkuara.

Kjo mospërputhje e pajisjeve me specifikacionin teknik te kërkuar nga autoriteti kontraktues ndikon edhe në aspektin financiar të përgaditjes së dosjes së tenderit nga ana e tenderuesve.

Autoriteti kontraktues duhet të jetë i kujdesshëm në rastin e punimit të specifikimeve teknike në mënyrë që tenderuesit mos të diskriminohen me rastin e ofertimit sepse ata i refereohen specifikimit teknik siç shkruan në DT në mënyrë që ta plotësojnë atë dhe nuk parashohin që autoriteti kontraktues do të pranoj edhe pajisje me specifikim të ndryshëm nga ai që shkruan në dosje të tenderit.

Shkeljet e konstatuara të LPP-së

Nuk janë respektuar nenet e LPP-së që janë përmendur në ankesë, gjatë vlerësimit të ofertave nga autoriteti kontraktues dhe si pasoje eshte rekomanduar per kontrate operatori ekonomik i pa pergjegjshem

Përgjigje në pikat e ankesës

Përgjigjeje për pikat e ankesës janë dhënë në konstatimet e lartshënuara.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues

Ekspertet shqyrtues-teknik e vlerësojn **<u>të bazuar</u>** ankesën e OE **"SOLUTION D".** Prandaj bazuar në gjitha konstatimet dhe sqarimet e dhëna gjatë shqyrtimit të kësaj lënde, ekspertët shqyrtues/teknik në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandojn që autoriteti kontraktues – **Spitali i Përgjithshëm në Pejë,** të kthej në **Ri vlerësim** aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me gjenerator ligashure(thik/koagulator) ultrasonik dhe bipolar i avansuar"** me nr. prokurimi 70030 17 008 121 në përputhje me dispozitat e LPP-së.